



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE ME RASTIN 7-VJETORIT TË PAVARËSISË
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 SHKURT 2015**

**SVEÇANE SEDNICE POVODOM 7-GODIŠNJE NEZAVISNOSTI
KOSOVA, ODRŽANE 17. FEBRUARA 2015. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2015**

Mbledhjen solemne e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa,
I nderuari zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,
E nderuara ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Jakobson,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
I nderuar nderi i kombit Adem Demaçi,
Të nderuar mysafirë, ish-presidentë të Republikës së Shqipërisë, zoti Mejdani dhe zoti Mojsiu,
Miq të Kosovës, familje të dëshmorëve, kryetarë të komunave, përfaqësues të medieve dhe ish-deputetë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e 7-vjetorit të kreutimit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës!

(Intonimi i himnit të Republikës së Kosovës)

(Drejtimitin e mbledhjes solemne e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Kadri Veseli.

KADRI VESELI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Jemi mbledhur sot, në këtë seancë solemne, që së bashku ta kremtojmë Ditën e madhe të Kosovës, 17 Shkurtin - Ditën e Pavarësisë.

Dita e Pavarësisë së Kosovës ka dimensione të shumëfishta.

Ajo është një ditë e përkujtimit për të gjithë ata qytetarë të Kosovës, që në kohë të ndryshme, në rrethana të ndryshme, vende të ndryshme dhe mënyra të ndryshme punuan për këtë ditë të madhe. Ata dhanë gjithçka nga vetja e tyre: jetën dhe mundin, dijen dhe pasurinë, u vranë në betejë dhe u shkatërruan burgjeve, përjetuan dëbimin dhe persekutimin, vetëm dhe vetëm që dita e Lirisë dhe Pavarësisë të zbardhë një ditë mbi qiellin e Kosovës.

Ata ishin nëna dhe baballarë që gjatë një shekulli robërie edukuan gjeneratat e Kosovës me idealin e lirisë e të pavarësisë,

Ata ishin të burgosur politikë, intelektualë e veprimtarë të pathyeshëm për të drejtat njerëzore,

Ata ishin arsimtarë dhe mjekë të Kosovës, gazetarë, bujq, minatorë, ndërtimtarë, të rinj dhe të moshuar, vajza dhe djem,

Ata ishin luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lavdi dhe nderim të përjetshëm Grave dhe Burrave të Kosovës, që e bënë të mundur këtë Ditë të Madhe të sotme.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Miq të nderuar, ambasadorë,
17 Shkurtin duhet ta përfjetojmë edhe si një ditë të madhe të nderimit, për miqtë tanë ndërkombëtarë - miqtë e Lirisë sonë.

Ata ishin bashkë me ne në rrugën tonë të lirisë dhe pavarësisë. Në vitet e vështira të rezistencës paqësore, kur bota po hynte në trazirat e post-komunizmit.

Ata na i hapën dyert.

E dëgjuan zërin e një populli të shtypur dhe na ndihmuan që ky zë të bëhej edhe më i fuqishëm.

Dhe më 5 mars 1998, kur në Prekazin e Adem Jasharit nisi kryengritja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e pranuan të vërtetën e madhe se kjo kryengritje në themel të saj e kishte vetëm një ideal: Lirinë - vlerën më të madhe të civilizimit perëndimor.

Kosova u përgjak, ndodhi dëbimi, masakrat, ndodhi edhe Reçaku, por ne nuk u thyem. Si rrjedhojë, erdhi intervenimi i Aleancës Veriatlantike në pranverën e vitit 1999.

Bota dhe Kosova po e përjetonin një ngjarje madhështore në historinë e njerëzimit.

Vlerat morale dhe humaniste po triumfonin mbi doktrinën e realizmit politik.

Parimi i të drejtave njerëzore mbi doktrinën rigjide të sovranitetit shtetëror. Respekt dhe nderim të përjetshëm!

Për të gjithë ata liderë politikë të botës perëndimore nga Uashingtoni në Berlin,

Për të gjithë ata gjeneralë dhe ushtarë të Aleancës Veriatlantike,

Për të gjithë ata gazetarë e intelektualë të botës që u rreshtuan në krah të Kosovës në ditët e saj më të vështira.

Ata e ndihmuan lirinë e Kosovës dhe bërjen e saj shtet. Kosova do t'ju jetë mirënjohëse përjetë.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
17 Shkurti, Dita jonë e Pavarësisë është edhe ditë e vlerësimit për punën tonë të përbashkët.

7 vjet pas shpalljes së pavarësisë ne duhet ta shohim rrugën që kemi ecur në ndërtimin e shtetit tonë të lirë dhe demokratik.

Janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Hallkat bazike të shtetësisë janë konsoliduar.

Zhvillimi demokratik i institucioneve ka ecur përpara. Vendi e gëzon një stabilitet të qëndrueshëm makro-ekonomik dhe rritja ekonomike ka ritme pozitive.

Por, një gjë duhet ta pranojmë të gjithë: vend për vetëmburrje nuk ka. Projekti i shtetformimit vazhdon të përballët me sfida të mëdha.

Ndonëse e kemi arritur një numër prej 108 njohjesh nga shtetet anekënd botës, jemi bërë pjesë e një numri mekanizmesh ndërkombëtarë, na mbetet ende punë e madhe për ta përmbyllur subjektivitetin ndërkombëtar. Pengesat janë të mëdha, por edhe mbështetja është e madhe nga miqtë tanë ndërkombëtarë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Ne duhet të vazhdojmë të punojmë ne partneritet të thellë me ta, sepse vetëm nëpërmjet këtij partneriteti ne mund të ecim përpara. Në duhet t'i ruajmë e t'i thellojmë raportet me miqtë tanë.

Mbi këtë bazë ne e kemi përqaftuar edhe platformën e dialogut me Serbinë, dialog i mbështetur nga Uashingtoni dhe Brukseli.

Dialogu për ne është nevojë, është standard, partneritet dhe instrumenti më i mirë për ta fituar paqen.

Kosova do të dalë e fituar nga ky dialog.

Në planin e brendshëm kemi bërë hapa të rëndësishëm në procesin e konsolidimit të shtetit, por edhe sfidat mbeten të mëdha.

Në rend të parë është sundimi i ligjit.

Pas 7 vjetësh pavarësi, është koha e fundit që Kosovën ta heqim nga listat e vendeve ku sundimi i ligjit ka probleme.

Rreziqet janë të mëdha nëse nuk e arrijmë këtë qëllim.

Pa sundim të ligjit nuk do të ketë përparim në integrimet euroatlantike.

Pa sundim të ligjit ne i shtyjme qytetarët që ta humbin besimin te shteti i tyre.

Pa sundim të ligjit askush nuk do të ndihet i gatshëm ta investojë kapitalin e tij në një biznes afatgjatë ekonomik në Kosovë.

E pa investime nuk do të ketë as rritje ekonomike, e pa rritje ekonomike nuk zvogëlohet papunësia, e as nuk rriten të hyrat e shtetit.

Pra, ta bëjmë sundimin e ligjit moralin tonë, nderin tonë, patriotizmin tonë. Le t'u tregojmë atyre që na ndihmuan se ne e merituar përkrahjen e tyre, por në të njëjtën kohë le t'u tregojmë atyre që ende nuk na kanë njohur se ne e meritojmë njohjen e tyre. Le t'u tregojmë gjeneratave që do të vijnë se ne e bëmë Kosovën shembull të zhvillimit, paqes, stabilitetit dhe bashkëjetesës pa dallime etnike dhe fetare.

Gjeneratave që vijnë, fëmijëve të fëmijëve tanë, le t'ua japim mundësinë të jenë krenarë me ne, me Kosovën që do t'ua lëmë trashëgim.

Le ta japim shembullin e një shteti ku dallimet në identitet ndërmjet nesh nuk janë kërcenim, por pasuri dhe përparësi për zhvillim.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne nuk kemi dilema për vlerat tona. Kjo na bën të sigurt në rrugën tonë të zhvillimit dhe integriteteve.

Në historinë e formimit të shteteve, Kosova është një tregim i suksesit dhe lajmet negative që herë pas here dëgjohen nuk mund ta rrëzojnë këtë fakt.

Kosova kurrë nuk ka qenë, e as nuk do të jetë vend që gjeneron ekstremizëm.

Toleranca është shpirti ynë.

Kosova kurrë nuk ka qenë dhe nuk do të lejojme të bëhet vend i shpresave të humbura për qytetarët e saj.

Qëndrimi në atdhe është shpirti ynë, jo ikja prej tij. Ndryshimi në atdhe është detyra jonë e përbashkët

Kosovën do ta bëjmë ashtu siç e deshën paraardhësit tanë, ashtu siç e duan pasardhësit tanë.

Gëzuar të gjithëve Dita e pavarësisë! Faleminderit!

(Duartrokitje)

(Drejtimin e mbledhjes solemne e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli)

KRYETARI: E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa për fjalë rasti.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga,
I nderuari kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Deputetë të nderuar,
Të nderuar ambasadorë,
Të nderuar përfaqësues të Bashkimit Evropian,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të dijes, të kulturës, të klerit, të shoqërisë civile dhe të medieeve,
Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të nderuar,
Ndiem i privilegjuar që kam rastin t'ju drejtohem sot, në 7-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, ditës kur përfaqësuesit tanë e bënë vendin tonë pjesë të familjes së madhe të vendeve të lira dhe demokratike të botës.

17 Shkurti i vitit 2008, është akti më madhështor i historisë së vendit tonë, është çasti më sublim i gjithë historisë së Kosovës. Kjo datë madhore, është kufiri kohor që ndan historinë e re të Kosovës nga e shkuara e saj tragjike.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës është rezultat i punës, i angazhimit, i dijes dhe i luftës së pandërprerë të popullit të Kosovës për realizimin e së drejtës më themelore të secilit popull, lirisë dhe mëvetësisë së tij.

Edhe popullit të Kosovës, si shumë popujve të tjerë liridashës, i është dashur të vuajë e të sakrifikojë shumë për të arritur ditën e shumëpritur të saj, Ditën e Pavarësisë. Ndaj, si gjithmonë, është momenti që t'i kujtojmë me nderim baballarët tanë, nënat, vëllezërit, motrat, bijtë dhe bijat më të mira të këtij vendi, të cilët, në vite dhe në rrethana të ndryshme, u flijuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Sot, dua ta kujtoj në mënyrë të veçantë Presidentin historik të Kosovës, Ibrahim Rugova, komandantin e UÇK-së Adem Jashari, luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe të gjithë ata që me vullnetin dhe përkushtimin e tyre punuan dhe u flijuan për të ardhmen e këtij vendi.

Dua t'i nderojmë bashkërisht sot edhe nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë, të cilët më nuk janë në mesin tonë, por që me aktin e tyre janë bërë pjesë e përjetësisë së Kosovës.

Edhe në këtë përvjetor, shprehim falënderimet më të singerta të Qeverisë dhe të popullit të Kosovës për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shtetet e Bashkimit Evropian, si dhe për të gjitha vendet e tjera anëtare të NATO-s, të cilat dhanë ndihmën e tyre vendimtare për çlirimin e vendit tonë.

Republika e Kosovës do t'u jetë përherë mirënjohëse këtyre vendeve, të cilat, faktikisht, e shpëtuan popullin e Kosovës nga gjenocidi, duke na mundësuar neve, po edhe mbarë rajonit, të nisim një epokë të re në marrëdhëniet e ndërsjella, të nisim epokën e integritimit në familjen e madhe të vendeve të lira e demokratike euroatlantike.

Dua ta falënderoj Shqipërinë dhe qytetarët e saj si dhe shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë e Bujanoc, për përkrahjen e madhe që na dhanë në ditët më të vështira që përjetuam në mbarim të fundshekullit të kaluar. Sot me Shqipërinë po integrohemi në fusha të ndryshme, rrugën e vështirë të cilën e kaluan qindra e mijëra njerëz tanë nga Kosova për të gjetur shpëtim dhe për tu strehuar në familjet shqiptare, sot e kemi zëvendësuar menjë rrugën e re, me lidhje të reja ekonomike, arsimore e kulturore, me integritime mbarë shqiptare.

Të nderuar pjesëmarrës të këtij manifestimi solemn,
Zonja dhe zotërinj,

Shtatë vjet të pavarësisë së Kosovës shihen ndryshe dhe vlerësohen ndryshe nga politikanë, qytetarët, shoqëria civile dhe institucionet ndërkombëtare.

Ata që drejtuan shumë procese gjatë kësaj periudhe si dhe ata që përkrahën proceset e mëdha flasin për arritje të mëdha, të tjerët numërojnë shumë nga premtimet e paarritura dhe të mbetura bosh, kurse Raporti i Progresit flet për ecuri pozitive por edhe për ngecje në fushat të cilat Kosova ka interes të bëjë hapa më të shpejtë si parakusht për integritime evropiane.

E vërteta e pamohueshme është për të gjithë ne, se e arritura më e madhe historike është vet pavarësia. Pavarësia për neve nuk është vetëm sinonim i mundësive dhe shanseve, është realiteti mbi të cilin e gëzojmë përgjegjësinë të ndërtojmë fatin tonë me duart tona, të bëjmë ardhmërinë tonë me vullnetin tonë, të ndërtojmë miqësi me popuj e vende të këtij globi me vullnetin e sovranit. E sovrani jemi ne vet, këta që jemi. Popull që mbijetoi nga shumë pushtime dhe pushtete të huaja, popull që shtëpitë i bëri shkolla kur shkollës iu vë dryni, popull që u bë një për t'i thënë jo shtypjes e tiranisë, popull punëtor në tokat e tij por edhe në shumë vende të botës.

Popull po ashtu që merr botën në sy, mbyll dyer e shet bagëti për të provuar jetën në mërgim. Dhe kur e shohim veten ashtu si jemi dhe jo vetëm ashtu si dëshirojmë të jemi, kuptojmë se edhe ne jetojmë me realitetin tonë, ashtu siç jetojnë edhe popujt e tjerë.

Kuptojmë se filluam më vonë nga të tjerët rrugën e tranzicionit, jo me fajin dhe dëshirën tonë, por se ishim të pushtuar, kuptojmë se për tu krahasuar me të tjerët duhet edhe të punojmë sa të tjerët, se për tu paguar e për të pasur sa të tjerët duhet të fitojmë sa ata, sepse jetojmë në një botë të konkurrencës së dijes dhe punës, ku të vetmen barazi e kemi se paguajmë çmime të njëjta dhe shtyhem në të njëjtin treg por se jemi të pabarabartë në zhvillimin ekonomik. E kjo pabarazi duhet të jetë motiv për punë e dije, motiv shtytës për arritje të reja, për tu barazuar dhe për t'i kaluar të tjerët.

Shohim se për 7 vjet pavarësi dhe 15 vjet nga çlirimi, Kosova ka ndryshuar petkun e saj,

jo vetëm në pikëpamje kushtetuese e juridike por edhe në infrastrukturën ekonomike e sociale. Ndryshimet janë të dukshme dhe të prekshme në të gjitha fushat, në zhvillimin e sektorit privat, në sektorin bankar, në infrastrukturën shkollore, shëndetësore, kulturore e sportive dhe sidomos në infrastrukturën rrugore në zhvillimin urban dhe zhvillimin rural.

Kosova sot është e pranuar nga 108 vende të botës, përfshirë edhe vendet lidere të botës. Kosova sot është anëtare e institucioneve më të rëndësishme financiare ndërkombëtare. Këtë vit Kosova do ta nënshkruaj Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim dhe neve na hapet mundësia të fillojmë marrëdhëniet kontraktuale me Bashkimin Evropian. Jemi i vetmi vend i privuar nga lëvizja e lirë dhe presim përkrahje nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave, në saje të përmbushjes së kritereve, sikurse edhe vendet e tjera.

Kosova për këto vite ka pasur një normë relativisht të mirë të rritjes ekonomike, por ajo nuk ka përmbushur nevojat për zhvillim më të shpejtë dhe zgjidhje të papunësisë. Numri i lartë i të papunëve dhe varfëria së bashku me korrupsionin e lartë dhe krimin e organizuar, janë sfida që i kemi para nesh.

Ne duhet ti zgjidhim këto, sepse ne jemi ata që duhet të krijojmë një ambient të volitshëm për zhvillim ekonomik, për tërheqje të investimeve të huaja direkte, për shfrytëzim të resurseve natyrore e njerëzore të cilat i kemi, dhe për punësim më të lartë. Në kulturën dhe dinjitetin tonë nuk është lavd të themi se jemi të varfër por lavdi qëndron në vendosmërinë tonë për mos të qenë të varfër. Ne nuk dëshirojmë të ndërtojmë një shtet në të cilin do të mburremi se po komunikojmë me të varfëritë, por një shtet nga i cili do ta flakim skamjen.

Do të flakim dhe korrupsionin dhe krimin e organizuar, do t'i flakim edhe tendencat oligarkike në ekonomi, të cilat ngulfatën zhvillimin dhe konkurrencën e lirë. Do të punojmë të gjithë së bashku, Kuvendi, Qeveria dhe shtylla e drejtësisë për të vënë rend dhe ligj, për të siguruar shtet të së drejtës.

Nuk do të lejojmë që shteti dhe institucionet të kapen nga individët, që shteti të kërcënohet nga rruga, që demokracia të zhvendoset nga Kuvendi në sheshe. Të gjithë ne do ta respektojmë votën, Kushtetutën dhe ligjin dhe asnjëri nuk mund të vihet mbi to. Demokracia nënkupton vullnetin e shumicës, votën e lirë të qytetarëve por edhe zbatim të rendit dhe ligjit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka program konkret për përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve tanë. Siç e kemi prezantuar tanimë, ky program është përqendruar në Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, punësimin dhe mirëqenien; Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor; Agjenda evropiane; Reformat cilësore në arsim dhe shëndetësi.

Realizimi i këtij programi do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme ekonomike të vendit, duke hapur perspektiva të reja për të gjithë qytetarët, e sidomos për të rinjtë, të cilët janë një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë sonë.

Kosova është vend i sigurt për të jetuar, vend që ofron dhe do të ofrojë perspektivë për

çdo qytetar të saj. Do të punojmë shumë për t'i përballuar problemet aktuale të papunësisë duke i dhënë prioritet bujqësisë dhe veprimtarive me vlerë të shtuar, të cilat punësojnë të rinj.

Do të krijojmë qasje në tregjet rajonale dhe evropiane të punëve sezonale përmes marrëveshjeve ndërshtetërore. Do ta ndryshojmë dhe përmirësojmë ambientin ligjor për të tërhequr investime të huaja direkte dhe kapital zhvillimor. Do ta reformojmë sektorin publik për të siguruar kushte të barabartë ekonomike dhe konkurrenë ndërmjet sektorit privat dhe atij publik dhe do të reformohet, po ashtu, sistemi i pagave, i cili do ta rrisë përgjegjësinë, efikasitetin dhe efikasitetin e të punësuarve.

Krahas zhvillimit ekonomik e punësimit, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe agjendës së integritetit euroatlantike të vendit tonë, si dhe ngritjes së nivelit të cilësisë së arsimit, në të gjitha institucionet tona arsimore, në mënyrë që nxënësit dhe studentët të marrin dije kompatible me ato të bashkëmoshatarëve të tyre kudo në botën e qytetëruar.

Njerëzit nuk kanë arsye të largohen nga Kosova, arsye kanë të qëndrojnë në Kosovë. Kosovarët nuk janë popull që jetojnë nga ndihmat, dhe ne e dimë se qindra e mijëra qytetarë tanë u kthyen në qershor të vitit 1999 nga Perëndimi, edhe pse kishin të drejta azili dhe kishin mundësi ta fitojnë atë.

Ata lirinë nuk e këmbyen me azilin, nuk e këmbyen me ndihma, por erdhën të jetojnë nga puna e tyre, në vendin e lirisë. Edhe sot pres që qytetarët tanë të kthehen e të punojnë në vendin e tyre. Ky është vend i sigurt për ta.

Të nderuar dinjitarë të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Republika e Kosovës është vend që angazhohet për paqe, bashkëpunim e fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e rajonit. Në këtë frymë, ne edhe jemi angazhuar në dialogun me Republikën e Serbisë, proces ky që po organizohet e po lehtësohet nga Bashkimi Evropian.

Ne kemi përqaftuar dialogun si mjet të vetëm për të zgjidhur problemet e trashëguara nga lufta dhe nga e kaluara. Dialogu si instrument i ushtrimit të sovranitetit në tërë territorin e vendit tonë dhe të integritetit të qytetarëve tanë po tregohet frytdhënës.

Rezultati i fundit i këtij dialogu është Marrëveshja e arritur për drejtësi, e cila do të mundësojë funksionimin normal të institucioneve të drejtësisë edhe në pjesën veriore të vendit, konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës synon që përfundimi i procesit të dialogut me Serbinë të jetë i suksesshëm për të dyja vendet, e kjo për ne nënkupton njohjen e ndërsjellë dhe integritetin në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Vetëm kështu do të mund të lihej pas e kaluara e dhimbshme, ndërsa popujve tanë do t'u jepej mundësia që, më në fund, të zinin hapin e zhvillimit e të përparimit të vendeve të tjera të kontinentit.

Mirëpo, edhe në këtë ditë, ne ritheksojmë se krahas politikës sonë të paqes dhe të mirëkuptimit, Kosova ka qenë shumë gjeneroze në ofertat për të drejtat e popullatës joshumicë të përmbledhura me marrëveshjen e arritur sipas Propozimit Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari dhe në Kushtetutë, si në asnjë vend tjetër.

Prandaj, ne presim nga përfaqësuesit e komuniteteve, sidomos atij serb që të jenë pjesë e institucioneve të Kosovës dhe të reflektojnë përcaktimin e tyre për këto institucione, si shprehje e përkushtimit për zgjidhjen e problemeve të çdo qytetari, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare e gjinore.

Të jetuarit në harmoni dhe në diversitet ka qenë njëra ndër vlerat unike të Kosovës gjatë shekujve dhe ne jemi të bindur se kështu do të mbetet edhe në të ardhmen.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Duke ju uruar edhe një herë 7-vjetorin e pavarësisë së Republikës, ju ftoj që të punojmë së bashku, në mënyrë që vendin tonë të dashur - Republikën e Kosovës, ta bëjmë shtet të përparuar dhe të zhvilluar, shtet të rendit e të ligjit, shtet të institucioneve të përgjegjshme e llogaridhënese, shtet në të cilin secili qytetar do të ndihet njësoj i rëndësishëm dhe njësoj i çmuar.

Republika e Kosovës ka nevojë për secilin nga ne, prandaj t'i japim asaj gjithçka që kemi mundësi t'i japim. Le të na bëhet moto e punës sonë thënia e njohur e Presidentit amerikan Kenedi: "Mos pyet çfarë mund të bëjë vendi yt për ty, por pyet ç'mund të bësh ti për vendin tënd".

Brezi ynë ua ka borxh këtë jo vetëm fëmijëve tanë, ardhmërisë së këtij vendi, por edhe brezave të mëparshëm, të cilët punuan dhe sakrifikuan shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Le të punojmë, pra, me dashuri dhe me besim se e ardhmja e Republikës së Kosovës dhe e qytetarëve të saj do të jetë më e ndritur dhe më e begatshme. Le të punojmë me angazhim e përlulësi, sepse ne, të gjithë, jemi të përkohshëm, ndërsa e përhershme është vetëm Republika e Kosovës, atdheu ynë i mrekullueshëm!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe popullin e saj!
Zoti i bekoftë të gjithë miqtë e Kosovës!
Ju faleminderit dhe urime!

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,
Duke ju falënderuar për pjesëmarrje, edhe një herë me urimin për 7-vjetorin e pavarësisë së Kosovës të gjithë qytetarëve të Republikës sonë, i mbyllim punimet e kësaj seance solemne. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*